



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë
Datë: 03.04.2026

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA E KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E KAMENICES - OPŠTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË CENTAR ZA USLUGU GRADANA CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z. /S.	Nr./Br./No.
12	8820
Nr. i faq. Br. Str. No. Pg.	Data Datum Date
3	03/04 2026
KAMENICË - KAMENICA	

Bazuar në nenin 17, 18, 19, 20, dhe 21 të Rregullores Sh.01.Nr.31251 të datës 29.09.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë shpall thirrjen publike për ndarjen e subvencioneve për bizneset e vogla dhe start-up:

THIRRJE PUBLIKE

Për mbështetjen e biznese të vogla dhe start up në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, përpunuese, shërbyese dhe ndërtimore që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal.

Shuma e përafërt e kësaj thirrje është 140,000.00€ (njëqind e katërdhjetë mijë euro).

Komuna e Kamenicës, shumën e fondit të vendosur në dispozicion për vitin 2026, do ta ndaj në dy kategori:

- LOT 1: Bizneset Start Up – 20% të fondit të përgjithshëm
- LOT 2: Bizneset ekzistues, ndërmarrjet mikro dhe të vogla – 80% të fondit të përgjithshëm
(me një qarkullim prej 500.00 € deri në 50,000.00€ nga viti i fundit kalendarik të dëshmuara nga ATK)

Çdo aplikacion i dorëzuar në këtë thirrje për mbështetje publike duhet të jetë brenda shumave vijuese minimale dhe maksimale:

Loti 1- Start-up

Nga 500.00 deri në 3,000.00 €;

Loti 2 Biznese ekzistuese - Ndërmarrjet mikro dhe të vogla

Nga 1,000.00€ deri në 5,000.00 €;

Përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët është obligative. Bashkëfinancimi i nevojshëm në kategorinë LOT 1 – Start – up, min 10%.

Bashkëfinancimi i nevojshëm në kategorinë LOT 2 – Biznese Ekzistuese, ndërmarrje mikro dhe të vogla, min 20%.

Veprimtaritë që nuk përkrahen:

- Shërbimet (flokataria, automekanikët, rrobaqepësia, gastronomia, aktivitetet shërbyese të pastrimit)
- Tregtia (me pakicë dhe shumicë);



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



- Ndërtimtaria (*instaluesit e ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit*)
- Bujqësia (*çdo pajisje apo aktivitet që ndërlidhet me fushëveprimtarinë e bujqësisë që financohet nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Ministria Bujqësisë, përjashtimisht pajisjet/makineritë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve*);
- Arsimi;
- Kultura, sporti dhe
- Shëndetësia.

Kriteret për aplikim:

1. Të jetë biznes që operon në Komunën e Kamenicës, ku edhe do të bëhet investimi;
2. Në rast se është start-up, regjistrimi i biznesit bëhet pas shpalljes përfitues,
3. Në rast se është start-up, të ketë një kualifikim profesional në fushën përkatëse
4. Bizneset duhet të jenë të regjistruara në Zyrën për Regjistrimin e Bizneseve në Komunën e Kamenicës
5. Të gjenerojë punësim me marrjen e grantit. Biznesi duhet të punësojë së paku një punonjës me marrjen e grantit. Punësimi i më tepër se një punonjësi për biznesin konsiderohet përparësi,
6. Përparësi kanë bizneset që udhëhiqen nga gratë, të rinjtë nën moshën 35 vjeçare si dhe komunitetet jo shumicë;
7. Bizneset duhet të kontribuojnë me vetëfinancim, me së paku 10% për bizneset start up dhe 20% për bizneset ekzistuese të vlerës së grantit të fituar.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Plotësimi i aplikacionit për bizneset Start UP; (Shtojca A)
2. Plotësimi i aplikacionit për bizneset ekzistuese; (Shtojca A_1)
3. Buxheti; (Shtojca B)
4. Deklarata e aplikantit; (Shtojca C)
5. Dokumenti identifikues personal valid të lëshuar nga Republika e Kosovës;
6. Certifikatë e vendbanimit (për persona fizik);
7. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, certifikata duhet të jetë e re, lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues; (e aplikueshme për bizneset ekzistuese)
8. Dëshmi për gjendjen shëndetësore (që përcakton aftësinë e kufizuar);
9. Dëshmi që i përket kategorisë së dalë nga lufta (Veterant i UÇK-së, invalid i UÇK -së, pjesëtar i familjes së dëshmorit);
10. Dëshmi për kualifikimin profesional – diplome, certifikate ose dëshmi të përvojës nga trusti në ndonjë biznes të fushës përkatëse (e aplikueshme për start up)
11. Dëshmi për pagesën e taksave komunale; (e aplikueshme për bizneset ekzistuese);
12. Vërtetim tatimor (*jo më i vjetër se data e shpalljes së thirrjes publike*) me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime)
13. Dëshmia për qarkullimin për vitin e fundit fiskal, lëshuar nga ATK;
14. Oferta/Profatura për pajisjet/makineritë e planifikuara në projekt (*oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta të ofruesit në ofertë dhe të dhëna sakta të marrësit të ofertës, gjithashtu oferta nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së thirrjes për mbështetje*).



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Vërejtje: Dokumentet e listuara më lartë duhet të jenë me dukshmëri të qartë. Dokumentet nga numri 1 deri në numrin 4, mund të shkarkohen në web faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

Përfituesit e granteve gjatë vitit 2024 dhe 2025 nga institucionet publike, nuk përkrahen me këtë thirrje.

Ndërsa për përfituesit e vitit 2023 kanë të drejtë aplikim por duhet të dëshmojnë qarkullimin gjatë vitit të fundit fiskal:

- *Bizneset Individuale (B.I.) me mbi 10,000.00 euro;*
- *Shoqëritë më Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K.) mbi 30,000.00.*

Pas përzgjedhjes dhe para nënshkrimit të kontratës, janë të nevojshme këto dokumente:

- Dëshmia bankare për mjetet e bashkëfinancimit.
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare.
- Certifikata e regjistrimit dhe informatat përcjellese (për bizneset start up).

Formularët e nevojshëm për plotësim: Shtojca A, Shtojca A_1, Shtojca B, Shtojca C, mund të shkarkohen në web faqen zyrtare të komunës së Kamenicës.

Afati i fundit për aplikim është 28 Prill 2026, ora 16:00. Aplikacionet e kompletuara do të pranohen në Qendrën për Shërbimet me Qytetarë.

Detajet e aplikimit mund ti gjeni të shtjelluara në udhëzuesin për aplikantët e granteve DZHED 2026 i cili është i bashkangjitur me të gjitha shtojcat e aplikimit.

Edon Dërmaku, Drejtor, DZHED

